

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Arsyeja e këtij diskutimi postfactum, pasi votimi ka ndodhur, është t'i sqarojmë qytetarët apo të jemi të drejtpërdrejtë me ta lidhur me çfarë diskutojmë, cilat janë të vërtetat dhe cila është pjesa që konsumohet për demagogji. Sinqerisht, nga një anë, nuk i keqkuptoj edhe kolegët e maxhorancës, të cilët si papagaj përsërisin gjëra që edhe nuk i kuptojnë, edhe nuk i dinë, ndërkohë që të vërtetat janë aty.

Teoria e jashtëzakonshme "si e gjetëm dhe ku e çuam" është një teori kaq e vjetër dhe e konsumuar, saqë kushdo që e ka përdorur nuk është se ka bërë hajër në këtë drejtim. Praktikisht, në rrafshin ekonomik, që të bëjmë vetëm një konsideratë të përgjithshme, ne kemi dëgjuar të gjithë qeverisjen që thotë: "Ku e gjetëm dhe ku e çuam". Ka vetëm një të dhënë, sintezë e të gjithë qeverisjes, që të ardhurat për frymë të shqiptarëve kanë qenë sa 30% e të ardhurave për frymë të Bashkimit Europian dhe janë saktësisht po aq edhe sot pas 30 vjetësh, ndërkohë që të gjitha vendet e tjera të rajonit kanë një rritje minimale 3 deri në 4%.

Se ku ishin dhe ku i çuan, këto nuk janë të dhëna të miat, por janë të dhëna të studimeve ndërkombëtare, publike në të gjithë globin, mbi të cilat vlerësohet Shqipëria. Kjo është. Mirë që problemet nuk ua zgjidhim qytetarëve, por t'u kursejmë gënjeshttrat. Njëherazi di edhe këtë gjë, që në kurriz të qytetarëve bien vazhdimisht vetëm ngarkesa të mëdha financiare, kjo dihet, sepse është bërë publike që qeveria në vend që të rindërtojë me kredi të buta, pra duke mos e rënduar borxhin gjithnjë e më shumë, është bërë publike që ndërton me paratë e saj për t'iu shmangur procedurave dhe për të grabitur më kollaj nëpërmjet tenderëve korruptivë, garave që nuk hapen, por bëhen me 1 apo 2 konkurrentë, gjëra tashmë të njohura publikisht, e për këtë shqiptarët duhet të paguajnë 130 milionë euro më shumë.

Megjithatë, po vij te çështja në fjalë. Çështja në fjalë ka të bëjë me një kredi të radhës, një projekt i gjatë me Bankën Botërore, i cili përsëritet dhe ecën dorë pas dore për një periudhë mbi 25 apo 27-vjeçare. Pra, nuk është as risi dhe asgjë e pangjarë. E vërteta është që ne të gjithë këtu prisnim, unë e kam kërkuar edhe në komision, nuk është që po e kërkoj këtu për herë të parë, që të kishte një demonstrim të qartë dhe të saktë që për secilën vepër spitalore dhe cilëndo ndërhyrje të saktësohej këtu, nuk u bë në sallën e komisionit po të bëhej këtu, që qytetarët dhe bashkë me ta edhe ne të duartrokasim dhe të jemi së bashku për të thënë se çfarë do të ndodhë konkretisht.

Projektet dhe paratë kanë destinacion, kanë objektiva dhe kanë saktësisht atë që do të kryhet, qoftë kjo infrastrukturë, teknologji mjekësore, teknologji diangnostike apo edhe formim personeli, shumë i domosdoshëm edhe ky. Kjo nuk ndodhi. Ndodh rëndom tanimë që sa herë merren kredi të njëpasnjëshme, sepse këtu rekordi i vendosjes së kredive është më i larti që mund të jetë regjistruar në të gjitha qeverisjet, po, e kam njohur edhe vazhdoj t'ia njoh meritat kësaj qeverisjeje që për të marrë borxhe, është borxhlija më e madhe që ka parë historia e Shqipërisë dhe që do të shohë edhe në të ardhmen, 2,6 apo 2,7 miliardë euro ka vajtur borxhi i marrë.

Në këtë traditë, ashtu siç u miratua, jo me votën tonë, një kredi tjetër për barazinë gjinore, në të cilën nuk kishte asnjë rresht apo fjalë për të, por ishin miliona të tjera, ky dihet që do të jetë më konkret, sepse Banka Botërore ka rregullat e saj, ka monitorim më të fortë, por qytetarët se çfarë do të ndodhë në realitet nuk dëgjuan gjë. Megjithatë, dëgjova këtu me shumë durim edhe nga kolegë, të cilët kanë një afërsi në fushën e mjekësisë, budallallëqe, si e gjetën mjekësinë. Kjo është një këngë idiote, mos e thoni më! Mirë Kryeministri se aq kupton dhe nuk duhet keqkuptuar asnjëherë, aq shkollë dhe vizion ka, në sipërfaqe është gjithmonë Kryeministri, nuk hyn në thellësi të gjërave, sepse nuk i dhemb për njerëzit, kjo dihet.

E thoni në kor “veglat e ndryshkura që gjetëm në mjekësi”. Mirë, nuk po u drejtohem atyre që nuk e kanë zanat, por atyre që e kanë zanat. Kur keni ardhur ju, bëhej kardiokirurgji në Shqipëri, bëhej neorokirurgji në Shqipëri. Po bëhej neuroradiologji në Shqipëri; bëheshin ndërhyrje ultrafine në të gjitha kirurgjitë, nga më të komplikuarat; erdhën për herë të parë akseleratorët

në Shqipëri. Me instrumente të ndryshkur, me sharrë druri apo me metafora idiote bëhen këto punë? T'ua kursejmë shqiptarëve këtë, se ata i kanë përballuar vetë këto shërbime. Idiotësia duhet të ketë limit, s'duhet të jetë kaq!

Për të vazhduar më tej, sot dimë që kemi një vdekshmëri foshnjore dyshifrore. Çështja nuk ishte si e gjetëm, ishte njëshifrore, jo sipas meje, por sipas drejtores së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, që konfirmoi në qershor të vitit 2012 publikisht këtë lajm të madh, që nuk dëgjohej për dhjetëra vjet. Dëgjova dikë këtu që tha: "S'kishin skaner". Si mund të gënjejnë njerëzit deri në këtë farë pike, kur në fund të vitit 2013 projekti rajonal pajisi me skanerë të gjitha qarqet e Shqipërisë, plus dy qarqe, të Lushnjës dhe Sarandës?! Është një e drejtë kushtetuese edhe gënjeshtër, edhe mashtrimi, madje është një simptomë psikopatologjike, e njohur në psikiatri.

Është turp publik të thuash gjëra që janë fakte reale! "Nuk u ndërtua një vepër që ta mbajmë mend", tha. E keni në mes të QSUT-së, një spital urgjence, ku vetëm pajisjet që ndodhen në katin e parë të imazherisë, laboratorit i analizave dhe reanimacionet e të gjithë urgjencës, e dinë të gjithë dhe e mbajnë mend që po të krahasohet me urgjencën e djeshme, ajo ndodhej në katin e parë të spitalit "6-katësh" dhe sot vepra është në mes të vendit. Kur ndodhi kjo? Nuk ndodhi atëherë?! Po neurokirurgjia nuk u bë atëherë?! Po djegieplastika nuk u bë atëherë?! Po kjo zonja Mathilde, mbretëresha e Belgjikës, a nuk erdhi në Shqipëri si ambasadore e promovimit të Shqipërisë, si vend lider në rajon për të gjitha programet e shëndetit primar dhe të vaksinimit?

Fakte publike këto, të përbotshme. Klikoni ku të doni dhe do e gjeni për pak minuta. Këto fakte nuk i them unë, por i di i gjithë rruzulli. Çfarë interesi kemi t'i themi këto histori? Thoni që nuk kemi përballuar asgjë, por u përballua një pandemi tjetër, pandemia e gripit të dërrit nga po ai laborator që ekzaminon sot, një laborator shumë i mirë, që dha një ndihmë të madhe për pandeminë e fundit të COVID-it, i cili është ngritur në fund të vitit 2009, me rastin e pandemisë së gripit të dërrit, së bashku me reanimacionin e infektivit, që u përdorën për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve. Pse duhet të gënjejmë? Është detyrë e qeverisjeje, e çdo ministri, qoftë edhe e maxhorancës të marrë stafetën e ta çojë më tutje, por që të gënjesh kaq haptazi...

Ne bëmë hapat e parë në neuroradiologji; tullën e parë për investimin e akseleratorit linear në neurokirurgji, i keni gjallë ata që punojnë atje, e ka vendosur Suzan Jakab në vitin 2012, jo unë, për fillimin e ndërtimit të bunkerit, të cilin e morëm se patëm disa projekte shumë të suksesshme me Agjencinë e Energjisë Atomike që na dhuroi këtë akselerator. A përfundon puna e mjekësisë? Absolutisht jo. A janë të gjithë në borxh me shëndetësinë? Absolutisht po. Këto që po them sot, i kam thënë edhe kur kam qenë në maxhorancë, edhe kur kam shërbyer si ministër, madje kam bërë debat më të madh seç kanë bërë këta me ministrat e po të njëjtës qeveri.

E mira, ajo që është fisnikja, ajo që të bën më të besueshëm te njerëzit, është të thuash: “Ishin këto çështje të mëdha; ishin të tjera që i çuam para; u përpoqëm t’ia dalim për të tjerat dhe kemi këto objektiva”, por mashtrimi pafund, ua them sërish, përveçse një sindromë psikopatologjike inferioriteti, nuk është asgjë më shumë. Faleminderit!